



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranimar / Doretuar Prinjenj / Prodato Received / Delivery	09.03.2023	3	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jednica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicima Quantity
SKIMSHICK	2532/2023		1/6



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.570/2021

Këshilli i Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani-kryetar, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë dhe Avdyll Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, bazuar në Aktgjykimin A.nr.1903/2021 të datës 31.01.2023 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.79/2019 të datës 08.02.2019 të parashtruar nga ankuesja

kundër Vendimit me Nr. prot:05-99 të datës 10.01.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Shëndetësisë, në çështjen juridike "masë disiplinore-ndërprerjeje e marrëdhënies se punës në Shërbimin Civil", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 09.03.2023, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.79/2019 e datës 08.02.2019 e parashtruar nga ankuesja

II. Shfuqizohet Vendimi me Nr. prot:05-99 i datës 10.01.2019 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Vendimi me Nr. 01/IX/2018 me Nr. prot:05-5906 i datës 04.09.2018 i Komisionit Disiplinor i Ministrisë së Shëndetësisë dhe çështja kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Shëndetësisë.

III. Obligohet Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Shëndetësisë, që brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të bëjë zbatimin e këtij vendimit, të bëjë rishqyrtimin e këtij rasti.

IV. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Shëndetësisë që të kujdeset për zbatimin e këtij vendimi.

V. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ushtruesi i detyrës së Drejtorit të SISH pranë Ministrisë së Shëndetësisë, me datën 10.08.2018, me numër protokoll 05-5382 ka përgatitur raportin për vijueshmërinë në punë për Sekretarin e Përgjithshëm të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Udhëheqësin e Personelit të Ministrisë së Shëndetësisë, me të cilin ka dhënë arsyetimin se _____ ka bërë shkelje të rënda serioze të detyrave të punës duke bërë hyrje dalje fiktive nga puna (Duke u regjistruar Koleget për njeri tjetrin (dhe pasi kanë vërejtur se është duke u regjistruar nga kamerat e sigurisë të njëjtit kanë lëvizur kamerën e sigurisë nga vendi”, duke rekomanduar që lënda të kalojnë Komisionin Disiplinor sipas rregullores përkatëse. Më datë 13.08.2018 rasti i ankueses është dërguar në Komisionin Disiplinor, ndërsa më datë 15.08.2018 ankuesja është njoftuar për rastin dhe është ftuar më datë 20.08.2018 të paraqiteni në seancë të Komisionit Disiplinor.

Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Shëndetësisë pas mbajtjes së seancës më datë 20.08.2018 dhe 04.09.2018, më datë 04.09.2018 ka nxjerr Vendim me Nr. 01/IX/2018 me numër protokoll 05-5906 me të cilin ankueses i ka shqiptuar masën disiplinore *“Ndërprerje e marrëdhënies së punës në Shërbimin Civil”*.

Ankuesja, e pakënaqur me Vendimin me Nr. 01/IX/2018 me numër protokoll 05-5906 të datës 04.09.2018 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Shëndetësisë, me datën 20.09.2018 ka parashtruar ankesë me numër protokoll 05-6281 në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave tek Ministria e Shëndetësisë. Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Ministrisë së Shëndetësisë, nuk ka nxjerr vendimin lidhur me ankesën e ankueses.

Ankuesja përmes përfaqësuesit të saj e pakënaqur Vendimin me Nr. 01/IX/2018 me numër protokoll 05-5906 të datës 04.09.2018 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Shëndetësisë, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 16.11.2018 ka parashtruar ankesë me numër protokoll 6893/2018 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 20.11.2018, ka dërguar kërkesën për përgjigje në aneksen e ankueses tek Ministria e Shëndetësisë, ndërsa me datën 23.11.2018 me numër protokoll 7117/2018, Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë nga Ministria e Shëndetësisë, me shkresat e bashkangjitura.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 26.12.2018 nxjerr Vendim A.nr.750/2018 me të cilin ka detyruar Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Shëndetësisë që të bëjë shqyrtimin e ankesës së datës 20.09.2018 të ankueses

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Ministrisë së Shëndetësisë, duke u bazuar në vendimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 10.01.2019 ka nxjerr Vendim me Nr. prot:05-99 me të cilin ka refuzuar ankesën e ankueses duke lënë në fuqi vendimin e Komisionit Disiplinor.

Ankuesja e pakënaqur me Vendimin me Nr. prot:05-99 të datës 10.01.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Shëndetësisë, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 08.02.2019 ka parashtruar ankesë me numër protokoll 691/2019 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli, në mungesë të kuorumit për vendosje, më datë 26.03.2019 ka njoftuar përfaqësuesin e ankueses lidhur me arsyet e mos shqyrtimit të ankesës dhe ka udhëzuar të njëjtin që t'i ndjek procedurat e mëtejme në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ. Ankuesi, në mungesë të kuorumit për vendosje ka ndjekur procedurat gjyqësore dhe si rrjedhojë ka hapur konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative.

Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, më datë 11.05.2021 ka nxjerr Aktgjykimin A.nr.888/19 me të cilin ka detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që të shqyrtoj dhe të vendos lidhur me ankesën e ankueses, mirëpo në momentin që Këshilli ka pranuar këtë aktgjykim ka qenë jofunksional dhe më datë 21.07.2021 ka njoftuar përfaqësuesin e ankueses lidhur me arsyet e mos shqyrtimit të ankesës dhe ka udhëzuar të njëjtin që t'i ndjek procedurat e mëtejme në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ. Ankuesi, në mungesë të kuorumit për vendosje ka ndjekur procedurat gjyqësore dhe si rrjedhojë ka hapur konflikt administrativ.

Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, më datë 31.01.2023 ka nxjerr Aktgjykimin A.nr.1903/2021 me të cilin ka detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që të shqyrtoj dhe të vendos lidhur me ankesën e ankueses.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokoll 691/2019 të datës 08.02.2019 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me Nr. prot:05-99 të datës 10.01.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Shëndetësisë; Ankesën me numër protokoll 6893/2018 të datës 16.11.2018 e parashtruar nga

ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me Nr. 01/IX/2018 me numër protokoll 05-5906 të datës 04.09.2018 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Shëndetësisë; Ankesën me numër prot: 05-6281 të datës 20.09.2018 e parashtruar nga ankuesja në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Autorizimin e datës 12.11.2018; Akt Emërimit të datës 01.10.2013 të ankueses; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punës i datës 11.01.2017 dhe 05.01.2018; E-mailin e datës 15.08.2018 të për ankuesen; Procesverbalin e datës 20.08.2018 dhe 04.09.2018 të Komisionit Disiplinor; Shkresën për dërgimin e lëndës në Komisionin Disiplinor e datës 13.08.2018; Raportin për vijueshmërinë në punës i datës 10.08.2018; Raporti i prezencës në punë për periudhën 01-09.08.2018; E-mailin e datës 08.08.2018 të I.L për E-mailin e datës 08.08.2018 nga për Procesverbalin e takimit të Departamentit të Sistemit të Informimit Shëndetësor për respektimin e vijueshmërisë në punës datë 10.08.2018; Dy CD; Vendimin A.nr.750/2018 të datës 26.12.2018 të Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Përgjigjen në ankesë e datës 23.11.2018; Përgjigjen e datës 26.03.2016; Aktgjykimin A.nr.888/19 të datës 11.05.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative; Njoftimin e datës 21.09.2021 dhe Aktgjykimin A.nr.1903/2021 të datës 31.01.2023 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Kolegji për Shqyrtimin edhe Vendosjen e Ankesave, për vendosjen e kësaj çështjeje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët dhe ka vërtetuar se ankesa e ankueses, është e bazuar, *sepse:*

Kolegji për Shqyrtimin edhe Vendosjen e Ankesave, shqyrtoi pretendimet ankimore të ankueses e cila pretendon se vendimi i Komisionit Disiplinor është i paqartë dhe konfuz pasi që nuk përshkruar veprimet konkrete të cilat i ka kryer ankuesja; nuk kam dëmtuar pronën e institucionit duke mos e prekurin objektivin e kamerës; gabimisht është theksuar se ankuesja ka munguar dy ditë të njëpasnjëshme nga puna; gjatë punës së kam marr vlerësime pozitive andaj masa e shqiptuar është e rëndë; edhe pas ndërprerjes së marrëdhënies së punës institucioni ka vazhduar të më angazhoj në komisione të ndryshme me çka vërtetohet se roli i saj është tejet i madh në institucion.

Kolegji i Këshillit, konstaton se Ligji Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ka përcaktuar që nëpunësit civil janë të obliguar që respektojnë dispozitat përkatëse në fuqi respektivisht nga neni 51 deri te neni 62 i Ligji Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, mirëpo i njëjti ka përcaktuar që nëpunësit për veprimet e tyre që bien në kundërshtim me dispozitat ligjore do të mbajnë përgjegjësi disiplinore siç parashihet me nenin 63, 64, dhe 65 të këtij ligji, ngase do t'u nënshtrohen masave disiplinore të parashikuar e dispozitat e nenit 66 dhe 67 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe dispozitave të Rregullores Nr. 04/2011 për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil, në këtë rast Kolegji i Këshillit, lidhur me pretendimin ankimor të ankueses dhe gjatë shqyrtimit të vendimeve të kontestuar me ankesën, ka konstatuar Vendimi me Nr. 01/IX/2018 me Nr. prot:05-5906 i datës 04.09.2018 i Komisionit Disiplinor i Ministrisë së Shëndetësisë është i paqarë dhe kundërthënës me vetveten siç parashihet me nenin 48 paragrafi 1 nën paragrafi

1.2, 1.3, 1.4, 1.5 dhe 1.6 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ndërsa arsyetimi i tij është në kundërshtim me paragrafin 2 të nenit 48 të këtij ligji, i cili parasheh se: *"Një arsyetim që është dukshëm i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërthënës apo i pakuptueshëm, është i barabartë me mungesën e tij"*, sepse nuk ka arritur të konstatoj saktë elementet e përgjegjesisë disiplinore të parashikuara me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregullores Nr. 04/2011 për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil, respektivisht nuk ka arritur të konstatoj drejtë shkallën e fajësisë së ankueses, po ashtu nuk ka shqyrtuar drejtë kërkesën për iniciimin e procedurës disiplinore sepse në bazë të saj inicuesi nuk ka përcaktuar kohën e shkeljes së supozuar disiplinore.

Nga të lartcekurat, duke marr për bazë provat materiale të lëndës, Kolegji i Këshillit, vlerëson se masa disiplinore e shqiptuar ndaj ankueses nuk është në proporcion me shkeljen siç parashihet me dispozitat e nenit 66 paragrafit 1 dhe 4 nën paragrafit 4.3 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i cili përcakton se: *"1.Masat disiplinore zbatohen në mënyrë graduale dhe në proporcion me pasojat dhe dëmet e shkaktuar nga sjellja e nëpunësit civil"*, sepse në bazë të shkresave të lëndës, rezulton se ndaj ankueses paraprakisht nuk ka pasur ndonjë masë disiplinore të aplikueshme dhe e cila ka qenë në fuqi.

Andaj, duke qenë se Vendimi me Nr. 01/IX/2018 me Nr. prot:05-5906 i datës 04.09.2018 i Komisionit Disiplinor i Ministrisë së Shëndetësisë përmban të meta të tillë të cilat pamundësojnë vendosjen meritore lidhur me këtë çështje administrative, Kolegji i Këshillit vlerëson që lënda duhet të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje te Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Shëndetësisë, me detyrimin që i njëjti të rishqyrtoj çështjen disiplinore lidhur me rastin e ankueses, të eliminoj shkeljet e konstatuara sipas këtij vendimi dhe të nxjerr vendim në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe në mbështetje të fakteve të vërtetuara në mënyrë të plotë dhe drejtë.

Po ashtu Kolegji i Këshillit, ka konstatuar që Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Ministrisë së Shëndetësisë me rastin e nxjerrjes së Vendimit me Nr. prot:05-99 të datës 10.01.2019 me të cilën ka refuzuar ankesën e ankueses ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën Administrative dhe Rregulloren Nr. 05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe të Ankesave, sepse nuk ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe juridike.

Kolegji i Këshillit, konstaton Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Shëndetësisë rastin duhet ta shqyrtojë me dispozitat ligjore që kanë qenë në fuqi, mirëpo meqenëse tashmë është i zbatueshëm Ligji Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë i cili në nenin 85 ka përcaktuar se: *"Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, shfuqizohet Ligji për Shërbimin Civil nr. 03/L-149 i Republikës së Kosovës dhe çdo dispozitë tjetër në kundërshtim me këtë ligj"*, atëherë më konsultim zyrtar me palën dhe nëse pala e vlerëson që është më e favorshme për të mund të vazhdoj procedurën sipas Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, siç parashihet me nenin 83 paragrafi 9, i cili përcakton se: *"...Për procedurat disiplinore në proces, nëse kjo është më e favorshme për nëpunësin civil në fjalë, me*

kërkesën e tij, zbatohen procedurat e ligjit të ri. E njëjta procedurë do të aplikohet për procedurat e ankesave dhe kontesteve”.

Duke marr parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe provat e bashkëngjitura në lëndë, Kolegji i Këshillit, bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi..

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.570/2021

Avdyl BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Eshref SHABANI

Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dërgohet

- Përfaqësuesit të ankueses,
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Shëndetësisë;
- Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Shëndetësisë;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Shëndetësisë dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së